



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 4-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 12.02.2026, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Shkelzim Olluri, anëtar
3. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
4. Murat Gërbeshi, anëtar
5. Fadil Sopa, anëtar
6. Armend Grajçevci, anëtar
7. Venhar Agushi, anëtar
8. Gentianë Hoxhaj - Gashi, anëtare
9. Elmaze Behluli, anëtare
10. Shefki Bytyqi, anëtar
11. Sanije Mehmeti, anëtare
12. Anila Reçica- Llugiqi, anëtare
13. Gentrin Sylja, anëtar
14. Rinor Murati, anëtar
15. Besim Jusufi, anëtar
16. Feriz Hasani, anëtar
17. Arsim Jashari, anëtar
18. Argjent Tasholli, anëtar
19. Liridon Hajrizi, anëtar
20. Herolind Kozhani, anëtar
21. Egzona Gashi, anëtare
22. Xhenetë Isufi- Mollopolci , anëtare
23. Yllëza Bedrolli, anëtare
24. Agon Bahtiri, anëtar
25. Alban Salihu, anëtar
26. Fatmir Fetahu, anëtar
27. Shahadije Bikliqi-Dragaçina, anëtare
28. Valenton Amrllahi, anëtar
29. Arjeta Statovci- Tasholli, anëtare

Të tjerë prezent:

1. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës
2. Latif Ramadani, DBF
3. Shkelzen Hajdini, DSHMS
4. Sead Aliu, SHPMM
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Safete Amerllahu, DGJK
7. Imri Semetishti, DUPMM
8. Ardian Olluri, DI
9. Ajkuna Maliqi, DA
10. Rexhep Rexhepi, DBPZHR
11. Rasim Hasani, DKA
12. Flamur Sylejmani, DI
13. Mehreme Goliqi, e propozuara për nënkryetare
14. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se para se me dal te rendi i ditës kemi një anëtar të Kuvendit Gentrit Syla, i cili e zëvendëson Rasim Hasanin nga subjekti politik LDK të cilin e ftoj të ngritët në këmbë dhe ta lexoj deklaratën e betimit.

SHTOJCË: Deklarata e Betimit

Unë Gentrit Syla “Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t`i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t`i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi në vazhdim rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja inauguruese, mbledhja 2-të dhe 3-të.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2025.
3. Propozim Vendim për fillimin e procedurës për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës.
4. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.

5. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve – strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.
6. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 15Nr.020/04-59398 datë 29.11.2024 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale në Lipjan.
7. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 15Nr.462/01-4918 datë 28.01.2025 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve.
8. Propozim Vendim për formimin e Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit.
9. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.
10. Propozim Vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme.
11. Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.
12. Propozim Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi- KKSB.
13. Propozim Vendim për formimin e grupit punues për hartimin e Projekt-Rregullores së re të Punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit.
Me propozim te ekzekutivit dhe me rekomandim te KPF-së, janë edhe dy pika shtesë të cilat kanë marr miratimin për dërgim në Kuvend. Po ashtu pas përfundimit të KPF-së, ka ardhë një kërkesë nga Asociacioni i Komunave të Kosovës për një pikë shtese për emërimin e delegateve në AKK.
14. Propozim Vendim për emërimin e nënkryetares së komunës për komunitete
15. Propozim Vendim për themelimin e mekanizmit koordinues lokal për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore në Komunën e Lipjanit
16. Propozim Vendim për emërimin e delegatëve të komunës së Lipjanit për përfaqësim në kuvendin e përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Arsim Jashari, tha se po bëhet një praktike jo e mirë që pikat me ardhë ditën që mbahet KPF-ja, dhe një ditë para mbledhjes së Kuvendit. Këto 3 pika i kam analizuar dhe asnjëra prej tyre nuk ka ndonjë urgjencë të veçantë. Do të ishte mirë që në mbledhjen e ardhshme mos me na ardh kështu pikat por të vijnë me kohë. Dhe e kam edhe një çështje tjetër te vendimi për zgjedhjen e nënkryetarit për komunitete, në bazë të këtij vendimi nëse e shikoni jeni jashtë kuadrit ligjor neni 58 pika 2 thotë decidivisht në ato rastet ku komunitetet jo shumica i kanë 10 % dhe ne me këtë vendim nuk mujna me votuar nënkryetarin për komunitete. Unë jam i lumtur që është e gjinisë femërore,

por me këtë vendim jemi jashtë kuadrit ligjor, me këtë vendim ne po e shkelim ligjin nëse votojnë. Pasi me regjistrimin e fundit të popullsisë komunitetet nuk i kanë 10 % të popullsisë.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se Ligji për Vetëqeverisje Lokale thotë që Kuvendi mund të propozoj dhe shtoj pika sipas nevojës. Të tri pikat që i kemi pruar sot nëse i lojna për mbledhjen tjetër kalon afati dhe për këtë arsye i kemi prurë në mbledhje sot. Pikat që kanë material shumë do ti sjellim në Kuvend 7 ditë para mbledhjes ashtu siç parashihet me ligj. Ndërsa sa i përket nënkryetares në rast se një komunë i ka me pak se 10% komunitete atëherë këtë kryetari ja delegon Kuvendit pastaj Kuvendi vendos nëse donë me votuar ose jo.

Shahadije Bikliqi, tha se le që po na vijne pikat me vonese po është dashtë që materialin për këto pika shtese me pas edhe në mënyre fizike për mbledhje.

Daut Azemi, Kryesues i kuvendit ,tha se materialin në mënyre elektronike ua kemi dërguar dje në email, ndërsa në mënyrë fizike e kemi hiq si kuvend prej seancave të kaluara. Kena marr vendim si kuvend që materiali të jetë vetëm në mënyrë elektronike.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 14 vota për, 15 kundër nuk kalon rendi i ditës dhe këtu e shpalli te mbyllur këtë mbledhje shihemi ne mbledhjen e radhës.

Menjëherë pas votimit pati reagime nga anëtarët e kuvendit se procesi i numërimit te votave ka qen gabim sepse ne salla jen 28 deputetë dhe se votat akne qen te barabarta 14 me 14.

Pastaj Kryesuesi i kuvendit tha kërkoj nja pauzë te shkurtër qe te verifikohet procesi i votimit.

Pas pauzës kryesuesi i kuvendit Daut Azemi, tha se po kthehemi ne mbledhje pas një gabimi qe ka bere zyrtari në numrin Naser Bytyqi, gjate votimit te rendit te ditës kane qene ne salle 28 anëtarë dhe numri i votimit ka qene 14 me 14. Ndërsa kane munguar Hyra Bytyqi, Fitim Shala dhe Fatmir Fetahu pas rishikimit u vërtetua se numërimi i votave ishte gabim dhe se me votën e dyfishtë të Kryesuesit u aprovuar rendi i ditës se bashku me 3 pikat shtese te propozuara. Duhet theksuar se nuk ka pas proces te ri te votimit për votim te rendit te ditës por për shkak te një gabimi te vogël teknik vetëm është konstatuar aprovimi i rendit te ditës qe ka qen dakordim i te gjithë anëtareve te kuvendit dhe mbledhja është vazhduar sipas rendit te ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtareve të Kuvendit.

Arsim Jashari, tha se para se me kaluar te pyetjet e anëtarëve të Kuvendit kam një kërkesë të veçantë ju e dini që me datën 17 shkurt ditën e Pavarësisë “Liria ka Emër” e ka organizuar një protestë gjithë popullore me moton e vetme “Drejtësi, jo Politikë”. Andaj ju ftoj të gjithëve që bashkërisht ti bashkohemi kësaj proteste. Pyetja e parë ka të bëjë me Drejtorinë e Inspektoratit, çka po ndodh me objektet që janë ndërtuar pa leje ku kemi pent house dhe kate shtesë, sipas ligjeve ndërtimet pa leje duhet të rrënohen. Pse inspektorati nuk po vepron a është ligji i njëjtë për të gjithë. Pyetja e dytë është dhuna që po ndodh në qytetin e Lipjanit nga nxënësit e shkollave 15-16 vjeçar, ku po ka rrahje therje dhe ju si ekzekutiv a jeni duke ndërmarr ndonjë masë preventive për me i ndaluar këto dukuri. Pasi që rastet e fundit që kanë ndodh kanë qenë shumë shqetësuese. Pyetja tjetër për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ku qytetarët po ankohen për rrugë të papastërta dhe rritje shqetësuese të qenve endacak. Çfarë masa keni ndërmarr ju si ekzekutiv për përmirësimin e këtyre shërbimeve. Ne kemi ndarë mjete një kompanie për qentë endacak por nuk e di a është duke u marr ajo kompani me këtë pune a jo.

Agon Bahtiri, tha kam një pyetje për lumin “Janjevka” ku jemi dëshmitar që gjatë vërshimeve në muajin janar lumi ka dal nga shtrati dhe janë rrezikuar disa familje. Kërkesë e qytetarëve është të thellohet shtrati i lumit dhe të ngritet një mur anësor 30 deri në 50 centimetra mbi nivelin aktual. Pyetja e dytë, a i merrni në konsideratë kërkesat e qytetarëve për shtrimin e rrugicave nëpër fshatra, a i merrni në konsideratë ato kërkesa apo i anashkaloni në bazë të bindjeve politike. Ne e dimë që ka shumë kërkesa për asfaltimin e rrugicave në fshatin Dobrajë të Madhe qe disa vite.

Xheneta Isufi, tha se unë e kam një pyetje e cila lidhet me një premtim të fushatës zgjedhore, që kam disa kërkesa nga qytetarët se kur do të filloj zbatimin i premtimit për subvencionimin për çdo fëmijë të posa lindur.

Argjent Tasholli, tha se kam disa pyetje e para për Drejtorinë e Arsimit, psikologja në shkollën “Zenel Hajdini” në Gadime dhe “Ernest Koliqi” në Babush nuk e dimë se kush është, ajo paguhet dhe asnjë aktivitet nuk e ka mbajtur në këto shkolla pres një përgjigje për këtë. E dyta rregullimi i urës në fshatin Gadime të lagja Isufi pse nuk po improvizohet një urë sikurse në fshatin Smallushë pasi gjatë vërshimeve të fundit ajo urë është dëmtuar dhe deri me tani nuk është ndërmarr asnjë veprim. Pyetja e tretë rishqyrtimi i vendimit për lirim të pagesës së çerdheve në fshatra apo ulja e pagesës me qellim që të mos ngarkohen çerdhet në qytet.

Yllëza Bedrolli, tha se paraqes kërkesën time lidhur me gjendjen e shkollës në fshatin Qellopek e cila me vite me radhe nuk ka pas investime të mjaftueshme infrastrukturore e as nuk është përfshirë në buxhetin komunal. Në këtë shkollë ende vazhdon të përdoret ngrohja me drunjë një formë e vjetërsuar dhe jo efikase e ngrohjes e cila ndikon negativisht si në procesin mësimor po ashtu në shëndetin e

nxënësve dhe stafit arsimor. Andaj kërkoj nga ekzekutivi i komunës që ta shqyrtojnë me prioritet gjendjen e shkollës dhe të përfshihet në planin e investimeve kapitale.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha se kam për ta ngritur një kërkesë që e kam ngritur disa herë ka të bëjë me rrugën “Zylfije Gashi” në Lipjan çka është duke ndodhur me atë rrugë pasi është në gjendje jo të mirë. Tjetra, ne grupi i LVV-së kemi pranuar një ankese nga një anëtar i komitetit për komunitete nga komuniteti turk, pasi sipas tij pala tjetër që është votuar në kuvend nuk e përfaqëson komunitetin turk. Si është puna për këtë a mund ta marrim një sqarim.

Nexhmedin Lekiqi, tha se çështja e parë që dua ta parashtroj është për stadiumin në Gadime ku i ka mbi 2 vite që ata po i mbajmë vjerrë para një kohe ne u ndamë në kuvend një parcelë me një zonë minerale dhe nuk ka aprovua nga ana e ministrisë, pastaj ne e zgjodhëm një lokacion tjetër me parcelë mbi 1.5 hektarë ku e kishte në shfrytëzim një bujk i cili dha dorëheqje nga ajo pronë për të ju dhën KF Gadimja. Por çuditërisht organet komunale nuk e panë të arsyeshme me ndare atë parcele dhe me dërguar në ministri dhe ministria e ktheu prapë. Përfaqësuesit e klubit po pyesin se çka po ndodh me këtë stadium. A pritet të bëhet një zgjidhje. Tjetra, në rrugën Gadime - Llugaxhi është bërë një bus stacion shumë i mirë por ka nevojë që të bëhen edhe në vendet tjera. Kam pyetje për DKA-në ende i kemi të përzier nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme, e di që ka qenë e planifikuar një shkollë në lagjen e Akllapit. Deshta me pyet ku jemi ne si komunë sa i përket kësaj çështje. E fundit ne jemi të zgjedhur të popullit dhe duhet nga një herë me u bërë të gjithë bashkë pozite e opozite për ti përkrahur të mirat e qytetarëve.

Arjeta Statovci- Tasholli, tha se jemi në dijeni për formimin e komisionit të dëmeve nga vërshimet. A ka përfunduar procesi i vlerësimit të dëmeve, nëse po pse nuk është paraqitur ende një raport zyrtar në Kuvend. Çështja tjetër në buxhetin e komunës është përfshirë edhe fasadimi i objekteve shumë banesore, kur pritet të fillojnë punimet pasi që disa nga këto objektet e kanë kaluar fazën e parë të aplikimit. A mund të na jepni një informatë rreth planit për planin e punimeve, afatet për këto objekte.

Rinor Murati, tha se dje është mbyllur thirrja publike për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit. Të nesërmen i kam dorëzuar kërkesë DKA-së, për iniciimin e ndryshimit të rregullores për ndarje të bursave. Kërkoj që kjo çështje të trajtohet.

Diamant Bytyqi, Nënkryetar i Komunës, tha se po mundohem në pika të shkurta ti adresoj disa prej përgjigjeve duke filluar nga pyetja e fundit po dje ka përfunduar afati për aplikim për bursa, dëshira jonë ka qenë që të ndryshohet rregullorja për bursa por për të mos humbur kohë e kemi shtyrë këtë rregullore për ndryshim plotësim pas ndarjes së bursave duke e diskutuar edhe çështjen e

studentëve që studiojnë jashtë vendit. Komisioni për vlerësimin e dëmeve ka përfunduar punën në teren në infrastrukturë publike, ekonomi familjare dhe bujqësi, por jo të gjitha dëmet do të kompensohen. Raporti vjen në Kuvendit pastaj shkon në agjencinë për menaxhimin e emergjencave. Një pjesë bëhet edhe nga Komuna e Lipjanit për zjarret. Objektet banesore ka qenë premtim i kryetarit por nuk e di deri ku ka shkuar. Për KF Gadime nuk ka munguar vullneti i ekzekutivit por vendimi është kthyer prej ministrisë. Por në mbledhjen në vazhdim do të zgjidhim këtë problem. Shkolla pritet të përfundoj dhe momentin që përfundon do të bartim atje. Rruga “Zylfie Gashi” është duke u bërë një paramasë për asfaltimin e rrugicave në qytet ku do të përfshihet edhe ajo rrugë. Shkolla në Qellopek ka qenë mirë me u propozuar në buxhet. Ose te bartja e të hyrave me shikuar. Ne e kemi sanuar urën në Smallushë, fal disa donatorëve, por për Gadime skemë mjete për momentin, mirëpo aty ka një rrugë alternativë derisa të bëhet një zgjidhje. Pagesa për çerdhe në fshatra është një çmim shumë i arsyeshëm për pagesë. Te subvencionet për të posa lindur është premtim i kryetarit dhe jemi duke e shqyrtuar mundësinë që ta realizojë. Lumi Janjevka, unë e kam vizituar me shtabin dhe lumi që ka rrjedh me se miri është ai. Lumi Janjevka nuk ka dal nga shtrati por ka dal lumi i Konjuhut jo lumi Janjevka. Një mur anësor është i nevojshëm. Rrugicat kanë qenë në buxhet por ju nuk e keni votuar buxhetin. Qentë endacak është një çështje serioze që po përballemi të gjithë ne e kemi një kontrate deri në fund të vitit por trajtimi nuk është e lehtë. Vetëm një komunë është e pa mundur me u marr me qentë endacak. Dhuna në shkolla po e kemi parë edhe përmes mediave, DKA u marr me këtë temë së bashku me Stacionin policor dhe nesër e kanë një takim regjioni i Prishtinës me komandantin e policisë së bashke me drejtorët e DKA-së. Objektet pa leje Drejtoria e Inspektoratit i ka marr të gjitha masat ligjore, disa prej tyre rasteve janë në Gjykatë. Për fasadimin e dy objekte do të jenë të gatshme deri në fund të vitit ato që janë me fondin e efiçinet.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se na në bazë të legjislacionit në fuqi kemi bërë thirrjen publike për anëtarë të komitetit për komunitete, për bazë kemi marr ai që ka marr më shumë nënshkrime. Edhe atë vendim pastaj pas votimit në Kuvend e kemi dërguar në MAPL dhe na është kthyer pozitivisht. Ankesën e kam marr pasi që është kthyer konfirmimi nga MAPL.

Argjent Tasholli, tha sa i përket urës në Gadime ka pas rrugë alternativë edhe në Smallushë ne nuk jemi kundër se është bërë mirë që është bërë ajo urë. Në Gadime te ajo urë kalojnë shumë fëmijë aty dhe lumi në atë pjesë është shumë i rrezikshëm. Duhet të ndërmerren sa me shpejt hapa për rregullimin e asaj ure. Ndërsa sa i përket çerdhës në fshatin Gadime, 6 muaj ka qenë pa pagesë dhe ka qenë e stër ngarkuar por tani nuk po them që është shuma e madhe, por disa familje po thonë që është shumë e madhe dhe nuk po ia dalin. Sa i përket psikologes në shkolla nuk mu përgjigje.

Arjeta Statovci- Tasholli, tha sa i përket banesave eficientë unë vet kam qenë pjese e procesit kur është bërë fasadimi te objekti përball shkollës fillore “Vëllezërit

Frashëri “ ku disa banorë te ky objekt kanë aplikuar në bazë të fondeve të MSS dhe kanë kaluar fazën e parë por janë të interesuar me ditë se çka po ndodh tutje kur do të fillojnë punimet.

Arsim Jashari, tha se edhe mua si shef i grupit të PDK-së, më ka ardhë kërkesa e anëtarit të komuniteteve nga komuniteti turk Skender Bikliqit por smu kujtua më herët.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit ,tha unë më herët e dhashë sqarimin për këtë çështje.

Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës, tha se ura në Gadime është shumë më e gjatë se ajo në Smallushë dhe nuk kemi mundësi me ndërtuar pa procedura të prokurimit. Te ura në Smallushë dhe disa intervenime tjera e kemi pas mbështetjen e kompanive të lipjanasve. Sa i përket fondeve të MSS ajo procedurë është ndërpre pasi që më ata nuk janë në Kosovë. Ne i mbështesim protestat jo politike që UÇK të jetë e pastër dhe historia jonë të jetë e pastër.

Rasim Hasani, tha sa i përket pagesës në çerdhe në fshatra nuk ka rast deri me tani që nuk e qon fëmijën në çerdhe për shkak të pagesës. Sa i përket psikologeve ne nuk kemi të mjaftueshëm për fshatra por kemi vetëm në qytet por ato shkojnë në fshatra aty ku ka nevojë.

Argjent Tasholli, tha për urën në Gadime është mirë që me shkua me u vendos shenja sinjalizuese të bllokimit që mos me kalua në atë urë. Sa i përket psikologes është e nevojshme që me pas edhe për pjesën e regjionit të Gadimes se është në mesin e shkollave më të mëdha në Komunën e Lipjanit.

Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës, tha se pranova një mesazh nga Kryetari i Komunës Imri Ahmeti, i cili tha se do të marr pjesë në protestën me mesazhin “Drejtësi, jo Politikë”. Edhe unë i ftoj të gjithë ata që kanë mundësi të i bashkohen kësaj proteste.

Meqë diskutime të tjera nuk pati u kalua në pikën e parë

I

Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja inauguruese, mbledhja 2-të dhe 3-të.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi ekstraktet nga mbledhja inauguruese, mbledhja 2-të dhe 3-të. Pastaj u kalua në pikën në vazhdim.

II

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2025.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Armend Grajqevci, tha së pari i uroj punë të mbarë anëtarit të ri të Kuvendit Gentrit Syles. Pastaj tha, sot po e shqyrtojmë raportin financiar për periudhën Janar Dhjetor 2025 një dokument që flet qartë se si janë menaxhuar mjetet publike të qytetarëve tanë. Buxheti për vitin e kaluar ka qenë mbi 27 milion euro ndërsa realizmi ka arritur mbi 94 %. Ndërsa sa i përket grantit qeveritar këtu kemi realizim mbi 97% kjo d.m.th. që mjetet që na kanë takuar janë menaxhuar me disiplinë dhe përgjegjësi. Ndërsa te kategoria e pagave dhe shtesave realizmi është 100% po ashtu edhe te subvencionet dhe transferet si dhe mallrat dhe shërbimet. Me këtë buxhet shihet që paratë publike janë menaxhuar me stabilitet. Ku qëllimi jonë është rritja e investimeve dhe përmirësimi i shërbimeve në ditët në vijim.

Egzona Gashi, tha sot po flasim për raportin e buxhetit për vitin 2025, po flasim për interesa publike të qytetarëve po flasim për qëllim në projekte për investime kapitale për zhvillim ekonomik. Ku fatkeqësisht nuk janë shëndërruar në projekte konkrete. Grantin qeveritar të përfituar nga qeveria është mbi 2 milion euro ndërsa mbi 500 mijë euro komuna nuk i ka shfrytëzuar dhe këto mjete ju kanë kthyer thesarit të shtetit me këtë komuna ka suficit buxhetor dhe me këtë komuna ka dështim të keq menaxhimit. Shumica e mjeteve që shkon në investim është te investimet kapitale, shuma tjetër për mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe pagesa për shtesa. Këto janë shifra të shkëputura nga realiteti, para të munguara, në rrugë, objekte publike, arsim, shëndetësi, kulturë sport etj. Ku këto mjete do të ndikonin në përmirësimin e jetës së qytetarëve por kjo tregon keq menaxhim institucional. Ne sot përballemi edhe me grant të pa shfrytëzuar, ndërsa në shkolla ka mungesë infrastrukurore dhe mungese të kushteve bazë dhe këtu kemi suficit mbi 50 mijë euro. Po ashtu kemi mjete të mbetura edhe në drejtori tjera si kulture, sport etj mbi 60 mijë euro. Kam një pyetje pse nuk keni arritur të krijoni të hyra nga qiraja e objekteve publike po ashtu te shfrytëzimi i pronave publike tregjeve ku janë planifikuar por nuk janë realizuar. Kërkoj sqarim pse nuk janë realizuar këtë mjete nga qiraja publike. Kërkoj edhe një sqarim pse grant i pa shfrytëzuar në shëndetësi, arsim kulture, rini

sport, pse këto grante nuk janë shfrytëzuar, cilat projekte kanë mbet pa u realizuar dhe kush mban përgjegjësi për këtë situatë. Po ashtu sa kemi garanci që edhe në të ardhmet këto mjete do te realizohet apo do te mbesin vetëm në letër, pasi që qytetarët kanë nevojë për projekte konkrete. Pse pagesa te vendimet e gjykatave është kaq e lartë dhe në rritje të vazhdueshme dhe pse nuk mban askush përgjegjësi për dëmet e shkaktuar buxhetit. Kur do të filloni të planifikoni buxhet për të drejtat e punëtoreve që ju takojnë nga kontratat kolektive. Këtë vërejte ua ka dhënë edhe auditori i jashtëm çdo vit dhe jeni zotuar që do ti zbatoni rekomandimet. Pres përgjigje nga ana juaj.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha se ne grupi i LVV-së e kemi analizuar buxhetin me vëmendje secilin cent të shpenzuar të buxhetit nga viti 2025 nga secila drejtori për secilën kategori. A ajo që kemi vërejt në këtë raport shfaq mënyrën me alarmante se si komuna ka menaxhuar shpenzuar buxhetin për vitin 2025 duke evidentuar shpenzime që për neve janë të pa justifikueshme. Tani do ti ngris disa çështje se si është keq menaxhuar buxheti i komunës, ku qindra e mijëra euro janë shpërndarë barte pa arsytim të qartë e pa interes publik duke e shfrytëzuar buxhetin në një mjet abuziv dhe jo të zhvillimit. Te investimet kapitale qindra mira euro kanë shkuar suficit si mjete të pa shfrytëzuara nga granti qeveritar që tregon një keq menaxhim dhe kjo është shqetësuese për neve qytetarët. Te investimet kapitale te parku qendror dhe nënkalmi paratë që janë planifikuar të shpenzohen për këto projekte janë dedikuar diku tjetër por jo aty ku janë planifikuar të ndahen e njëjta ka ndodh edhe me qendrën urgjente. Po ashtu ka paqartësi te të hyrat vetanake dhe te hyrat e bartura. Bazuar në këtë raport Komuna e Lipjanit vetëm për nafte ngrohje qendrore e derivate për automjete ka shpenzuar mbi 96 mijë euro. Për ngrohje për dru mbi 300 mijë euro. Po ashtu shumë shpenzime në emër të shërbimeve të tjera kontraktuese mbi 280 mijë euro. Gjithashtu për mirëmbajtje rutinore janë mbi 700 mijë euro. Shqetësuese mbetet edhe ndarja e mjeteve për përfituesit individual ku Drejtorja e Administratës ka ndarë mbi 80 mijë euro, pastaj drejtorisë 250 mijë euro për mirëmbajtje të rrugëve lokale. Për qira të automjeteve janë ndarë 6 mijë euro. Pra është për keqardhje se si është shpërndarë ky buxhet dhe ne kërkojmë sqarime për të gjitha këto.

Agon Bahtiri, tha se dua të diskutoj rreth grantit qeveritar ku mjete të pa shpenzuara janë mbi 500 mijë euro, nuk janë planifikuar mirë këto mjete pasi që është dashtë që me këto mjete me planifikuar ndonjë projekt pasi që ka pas shumë nevojë Lipjani për projekte të cilat janë në të mirën e qytetarëve. Shembull keni disa shkolla në komunën tonë ku disa klasë ende nxehen me stufa me dru dhe është dashtë në këtë rast me pas ndonjë projekt ku do të përmirësoheshin kushte në shkolla duke sjell pajisje eficientë moderne ose tabelë digjitale. Po ashtu te investimet kapitale kemi

performancë jo të mirë pasi që buxheti është shpenzuar vetëm 73% duke u vonuar në mos realizim të projekteve. Si shembull konkret e kemi mbikalimin dhe parkingun ku u dashtë me përfunduar në vitin 2025 ndërsa sot në vitin 2026 ende punët vazhdojnë me një ritëm e ngadalshëm dhe nuk e dimë ende kur ky projekt do të shpallet i mbyllur.

Arsim Jashari, tha se do te ishte mirë Nënkyetar që neve anëtarëve të Kuvendit me na i prezantuar dy drejtoret e rijnë, pasi që është praktikë me i prezantuar. Sa i përket raportit disa herë e kam diskutuar punën e kontratës kolektive që nuk ka buxhet të veçante për pagesën pasi që ato i ka lidhe ministria e jo komunat, por cila është arsyeja që përfaqësuesit ligjor po i detyroni me bo ankese në shkallen e dytë kur e dini që atë lendë do ta humbni. Është mirë nganjëherë mi marr do këshilla të mira që ua jepmi ne si anëtar të Kuvendit.

Nexhmendin Lekiqi, tha se edhe unë pajtohna me parafolësin për prezantim po ashtu deshta me i falënderuar për kontributin të gjithë anëtarët e legjislaturës se kaluar në veçanti Lulin dhe dr. Egzonen

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha është mirë që me u fokusuar te pikat e rendit të ditës se ne në fillim i kemi falënderuar të gjithë për kontributin e tyre.

Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës, tha edhe unë i falënderoj ish anëtarët e Kuvendit nga pozita, dr.Gazin, Albionen, mësuesin Sami, për kontributin e tyre por edhe të gjithë anëtarët e tjerë.

Latif Ramadani, tha se ne e kemi obligim ligjor me raportuar për shpenzimet që kanë dal në vitin e kaluar. Është mirë me analizuar jo me fol pa fakte. Ka suficit të buxhetit por ne si komunë asnjë cent nuk e kemi borxh. Suficit kanë shkuar por nuk kemi bërë vepër penale. Aty ku nuk kanë kryer punën kompanitë ne nuk i kemi paguar dhe për atë kanë shkuar mjetet suficit. Shumë shpejt do ta keni në Kuvend edhe për bartjen e mjeteve. Ju kemi thënë disa herë që nuk ka kod të veçantë për pagesat për kontratën kolektive pasi që komunat nuk janë nënshtruese. Dhe ato do të ekzekutohen përmes përmbaruesit pasi që nuk ka mënyrë tjetër. Nuk ka derdhje financiare ka një pasqyrim të një raporti për punën e bërë në vitin 2025. Shërbimet kontraktuese tjera janë shërbimet e Komunës, pastrimi i varrezave pastrimi i rrugëve parqeve, etj.

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim

III

Propozim Vendim për fillimin e procedurës për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit, drejtor i DPUMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha për hir të anëtareve të rijnë, një shpjegim me hartimin e këtyre hartave zonale metri katror i banesës ka qenë në vitin 2021 diku 350 deri 400 euro metra, ndërsa sot ka shkuar 600 deri 900 euro. Sot po merremi me inicimin e ndryshimit të hartave zonale përkatësisht nenit 3 te këtij vendimi një initiative e cila po vie me vonesë si pasoj e gabimeve të marr nga vendimmarrja e gabuar. Në vitin 2021 kur janë votuar harta zonale ato përfshifshihen edhe banueset ndërtimore për zbatimin e të cilave ishte obligim edhe të bëhej një rregullore e veçantë. Kjo rregullore nuk është formuar asnjëherë nga ekzekutivi dhe për pasoje asnjë nga këto bonuse nuk është zbatuar. Kjo përbën shkelje të vendimit të Kuvendit. Në vitin 2021 ne si opozite kemi kërkuar qartë që të merret për bazë gjendja faktike dhe problemet reale në teren, pikërisht ato që sot po tentohen të adresohen përmes nenin 3. Këshillat dhe kritikata tona kane qenë profesionale dhe të bazuara në fakte por nuk janë marr për bazë. Për herë të korrektësisë ky drejtori më herët nuk ka qenë drejtor i këtij drejtorati. Po ashtu në vitin 2022 një propozim i ngjashëm ka ardhë në Kuvend dhe është dërguar në ministrinë përkatëse dhe është refuzuar. Ministria e ka refuzuar me faktin se ndryshimet se nuk janë të harmonizuara me planin komunal, krijonin mos përputhje në mes të parametrave urban dhe nuk garantonin siguri juridike në zbatimin e lejeve ndërtimore. Kështu ka qenë arsyetimi i ministrisë. Ndërhyrjet aktuale në nenin 3 përfshijnë të njëjtat fusha, rrugët, parcelimin, ballinën ,vijën ndërtimore, etazhitetin dhe koeficientin e ndërtimit. Ndryshimi është vetëm terminologjik tani quhen ndryshim plotësim ndërsa në vitin 2021 harmonizim teknik. Këto ndryshime nuk mund të bëhen pa miratimin e planit zhvillimor lokal. Tash pas 4 vite po kthehemi për të thënë se ka probleme por këto janë që ju vet i keni injoruar kur keni mujt mi zgjedh pa pasoja për qytetarët dhe bizneset. Ne grupi i PDK-se, nuk e kundërshtojmë korrigjimin e gabimeve por do ta mbështesim dhe përkrahim për të mirën e qytetarëve.

Rinor Murati, tha sa i përket këtij propozim vendimi mund të themi se harta zonale janë ndër dokumentet kryesore të planifikimit urban për një qytet krahas planit zhvillimor komunal. Për këtë arsye ajo duhet të analizohet përpunohet me përpikëri të plotë profesionale duke i reflektuar nevojat e zhvillimit urban. Inicimi i ndryshimit të hartës zonale paraqet një hap të domosdoshëm për krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillim të qëndrueshëm investime të reja dhe cilësi të jetesës për qytetarë. Për sa kohë pritet të përfundoj procedura e ndryshim plotësimit nëse e kemi dhe aprovimin e nivelit qendror.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha sa i përket pikës për rishikimin e ndryshimit të hartave zonale të Komunës së Lipjanit po tentohet të bëhet ashtu siç ndodh zakonisht, si një proces teknik ku fokusi vie me shumë në korigjime sanime e përshtatje procedurale, e më së paku planifikimi i mirëfillti i komunës. E vërteta është se Lipjani po rritet më së shpejti në Kosovë qendra urbane e qytetit po zgjerohet në një hapësirë të madhe. Lipjani më tani më nuk është një qendër e vogël që mund të fokusohet vetëm me një qendër një shkolle dhe një park, por duhet të formësohet në lagje të planifikuara secila me identitetin e vet funksionin dhe infrastrukturën përkatëse. Nëse vazhdon gjendja e njëjtë Lipjani do të bëhet si Fushë Kosova e Prishtina. Ku kemi një qytet të ngulfatur nga trafiku, nuk kemi rrugë funksionale. Ndërsa në fshatra shkolla me nga 4-5 nxënës fusha sportive që përdoren radhë kjo është si pasoj i kësaj harte zonale të pa mirëfillte. Ne nuk do të lejojmë ndërtimin e Lipjanit pa një planifikim të mirë bazuar në studime të popullsisë, dendësise dhe frekuentimit të funksioneve banim afarizëm. Koncepti mbi të cilin duhet të zhvillohet lokali është koncepti i lagjes.

Armend Grajqevci, tha se para vetës kemi një dokument të rëndësishëm ndryshimin e hartave zonale , ku paraqitet sakt drejtimi dhe zhvillimi ekonomik, urban esencial për vitet në vijim. Këto ndikojnë drejtpërdrejt në investime, planifikim të infrastrukturës, zona të banimit, hapësira për biznese dhe në përgjithësi për jetën e qytetarëve. Realiteti është se Lipjani ka ndryshuar ndër vite, ku ka pas kërkesa për ndërtim, për biznese, zgjerim të zonave të banimit dhe infrastrukturë shtesë. Do të kemi parasysh se harta zonale duhet të përditësohen për nevojat e qytetarëve. Ndryshimi i këtyre hartave duhet të bëhet në bazë të kushteve të parapara në këtë vendim. Ky proces duhet të shërbej për rregulla urban. Ne grupi i LDK-së e mbështesim këtë vendim për të mirën e qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Alban Salihu, tha se këto harta kanë nevojë për ndryshime dhe plotësime por unë jam i bindur që ndryshimi i këtij vendimi po bëhet që Komuna të ju nënshtrohet ndërtuesve. Pas pak viteve Lipjani do ti ngjaj Fushe Kosovës si katrahure urbane.

Agon Bahtiri, tha se sa i përket këtij propozimi për ndryshim plotësimin e hartave zonale ne partia e PDK-se, kemi reaguar qysh në vitin 2021 dhe me plot të drejtë pasi që nuk janë respektuar kriteret e caktuara për harta zonale. Te pika e dërguar shihet se ka shumë gabime mos përputhje dhe shumë arsye pse duhet me u bërë ndryshimi i hartave zonale. Ka rrugë mbi rrugë të planifikuara të cilat nuk përputhen me gjendjen aktuale në teren. Duke i parë këto shihet se interesi është te zona B1 dhe B2 për rregullimin e koeficientit të ndërtimit. Ministria nuk do ta marr parasysht sepse ligji përcakton saktë se nuk mund të fillon më ndryshim të hartave zonale ku nuk ka plan për zhvillim komunal.

Imri Semetshti, tha se ne e kemi një dokument i cili është i zbatueshëm dhe ka sjell një rregullim në atë mënyrë. Natyrisht që harta i ka do gabime dhe ky është qëllimi i inicimit të hartës. Sikur të fillonim një dokument të ri mund ti bënim të gjitha, por ne kemi një dokument të cilin vetëm mund ta ndryshojmë plotësojmë. Gabimi më i madh është ne viktorizim ne infrastrukturën rrugore. Me të drejt dikush e ngriti shqetësimin se nuk e kemi Planin Zhvillimor Komunal, por fatkeqësisht kjo ministri e ka miratuar në vitin 2021 që e kemi në fuqi pa miratim paraprak të PZHK-së. Dhe në vendim ka përcaktuar detyrimin për PZHK. Ne kemi përgjegjësi ta qesim problemi aq sa kemi kompetencë dhe nuk ka tendencë për të bërë katrahurë urbane sa të jem unë. Nuk ka tendencë me e favorizuar askënd dhe këto kriteret të cilat janë duhet të zbatohen nga të gjithë. Çdo ndryshim qëllimi është me u zgjidh disa probleme që me pas zbatim me shume harta zonale.

Arsim Jashari, tha se dy çështje dua me i diskutuar, në harta zonale ka qenë e planifikuar hapja e disa rrugëve pse nuk janë hap ato rrugë. Bllokimi ose mos shfuqizimi i PZHK paraprake me te riun mos është problemi te deponia sepse duhet ta dinë qytetarët se ku qëndron problemi. Por edhe nëse kalon prapë do të jetë problem me u zbatuar këto harta sepse nuk ka PZHK.

Alban Salihu, tha se ju po thoni se sa të jam unë këtu nuk keni me parë kaosin urbanistik, por ne atë po e shohim edhe sot , një shi me ra një ditë ose dy po bllokohet qyteti. E kemi rastin e fundit te nënkalimi. Sot nuk e ke asnjë lagje urbanistikë të banueshme si duhet në Lipjan. Në qytet ke ndërtesa shumë afër njëra me tjetrën.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se kur ka reshje edhe shtetet e Evropës po bllokohen e le Lipjani, gjithmonë ka pas reshje dhe ka me pas deri sa të rregullohet shtrati i lumit Sitnica në krejt Kosovën.

Nexhmedin Lekiqi, tha se ne ter kohen po flasim vazhdimisht se po ka zhvillim te madh dhe se infrastruktura nuk po e përcjell këtë zhvillim. Ndërsa çmimi aktual për një metër katrorë prej 3 euro për investitorin është ofendues pasi qe insvitori po ben nje ivetsim milionsh ndërsa taksen e ka 3 euro per metër duhet qe kjo takse te shumëfishohet ose trefishohet.

Feriz Hasani, tha se pari duhet te jemi konstruktiv pozitivë opozite për te mirën e qytetarëve dhe kjo çështje është mire te shtyhet përpara pasi qe po behet edhe për te mirën e qytetarëve dhe te bizneseve.

Imri Semetishti, tha se as drejtorati për urbanizëm dhe askush nuk ka të drejtë ta ndal zhvillimin

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për,3 abstenime aprovoi propozimin

Pastaj Kryesuesi dha pauzë nga ora 12:40 deri ne 14:00

IV

Propozim Vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit, drejtor i DSHPS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se para vetes kemi vendimin për lirimin nga pagesa e qerases joprofitabile të përfituesve të banimit social te cilët kane nevoje dhe janë ne kushte te vështira ekonomike. Mirëpo për te pasur drejtësi dhe transparence kërkojmë formimin e një komisioni verifikues për te shikuar gjendjen aktuale ekonomike sociale te përfituesve. Pra kërkojmë një raport ne kuvend për gjendjen e tyre. Ne grupi i PDK-së e mbështesim këtë propozim vendim por duhet qe te formohet një komision dhe te vjen një raport ne kuvend për këto raste qe me dite gjendjen e tyre.

Gentianë Hoxhaj Gashi, ne emër të grupit të LDK-së e mbështesim këtë propozim vendim sepse prek familjet me më nevojë të komunës sonë. Përfituesit e banimit social. Përfituesit e banimit social janë qytetare që përballen me vështirësi të mëdha ekonomike dhe falja e këtyre borxheve do të ja lehtësojnë gjendjen.

Shahdije Bikliqi Dragqina, tha ne grupi i LVV-së e mbështesim propozim Vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social. Por një sqarim a ka një raport për gjendjen e këtyre familjeve.

Argjent Tasholli, tha se këtë vendim duhet ta mbështesim si kuvend ku janë në pyetje familjet e skemave sociale. Por ju si ekzekutiv duhet të mendoni me shume për te ardhmen e këtyre familjeve duhet të mendoni subvencionimin e qeras për këto kategori. Sipas ligjit të neni 10 te subvencionimi i qesasë komuna mund të ofrojë subvencionimin për pagesën e qerases për individ dhe familje që plotësojnë kushte sociale. Dhe me këtë komuna do të ua lehtësonte gjendjen këtyre familjeve.

Arjeta Statovci-Tasholli, tha se e mbështesim këtë propozim por si anëtarë të ri të kuvendit do të ishte mire që të na njoftoni me këtë proces. A është përditësuar ndonjë here lista e këtyre përfituesve në përputhje me gjendjen ekonomike të tyre. Do të ishte mire të kemi një raport dhe listë të shohim se kush janë këto familje dhe në baze të çfarë kritereve janë përzgjedh këto familje.

Shkelzen Hjadini, tha se behet fjale për 31 familje të cilat kanë qene përfituese nga komuna e Lipjanit dhe ajne kryesisht familje që janë në nevojë të cilat i ka përzgjedhur komisioni. Ju falënderoj që po e mbështesni këtë propozim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve – strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit drejtor i DSHPS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Rinor Murati, tha se edhe këtë vit sikurse vitet e kaluara e mbështesim këtë propozim dhe urojmë që te këtë sa me pak raste te tilla.

Xheneta Isufi, tha ne grupi i PDK-së, e përkrahim këtë propozim vendim, por kërkojmë që te ndahet një shume e caktuar për periudhën 6-muaj deri një vit për përkrahjen e rasteve te dhunës. Pasi që këto raste janë sfide ne vete.

Shahdije Bikliqi Dragqina, tha ne grupi i LVV-se e mbështesim këtë propozim ashtu siç e kemi mbështet edhe vitet e kaluara pasi që e konsiderojmë je kategori mjaft te ndjeshme. Dhe urojmë që raste te tilla te dhunës ne familje mos te këtë sa me pak.

Shkelzen Hjadini, tha se lidhur me subvencionimin e rasteve te dhunës ky është njeri nder llojet e subvencionimit dhe do te vazhdojmë ti mbështesim këto raste

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi propozimin

VI

